

MARENGLLEN VERLI

SITUATA DEMOGRAFIKE, ETNIKE, FETARE ETJ., NË VISET E “SHQIPTARËVE TË VERIUT” NË VITIN 1877, SIPAS VLERËSIMIT TË DIPLOMACISË AUSTRO-HUNGAREZE DHE NJË VËSHTRIM MBI SHPËRNGULJET NGA SANXHAKU I NISHIT*

Në gjysmën e dytë të shek. XIX, në dokumente të ndryshme të diplomacisë europiane të kohës, e posaçërisht asaj austro-hungareze, gjendet një informacion me vlerë për situatën demografike, etnike, fetare, por edhe sociale, ekonomike, kulturore etj., të Ballkanit osman e në kuadër të saj edhe për botën shqiptare. Aty kemi gjetur të dhëna edhe për numrin, përbërjen etnike dhe besimet fetare të popullsisë së sanxhaqeve ose vilajeteve të quajtura shqiptare, gjithashtu për tiparet e banorëve, të çdo kombësie, për gjendjen e tyre ekonomike, sociale, kulturore etj. Interesimi i posaçëm i Perandorisë Habsburge për rajonin e Ballkanit, në konkurrencë veçanërisht të ashpër me Perandorinë Ruse, për pasojë ngritja e dendur e konsullatave në territorin e Ballkanit osman, kualifikimi përgjithësisht i lartë i personelit të tyre dhe, po kështu, burimet mjaft të besueshme zyrtare e jozyrtare të informacionit që ato siguronin, janë tregues për të krijuar bindjen se të dhënat arkivore të diplomacisë vjeneze të kësaj periudhe meritojnë vlerësim serioz dhe janë për t’u marrë në konsideratë.¹

Për shkak të ballafaqimit substancial për të zotëruar Ballkanin, kuptohet rëndësia që kishte për Vjenën vjelja e informacionit sa më të saktë për situatën demografike etnike e fetare në rajon dhe potencialin njerëzor, forcën ushtarake, dhe prirjet politike të popujve që e banonin atë. Në bazë të këtij informacioni llogariteshin avantazhet dhe disavantazhet për realizimin e projekteve gjeostrategjike, llogaritej forca e “miqve”, ku bënin pjesë shqiptarët, dhe e “armiëve” ku bënin pjesë

* Referat i mbajtur në *Kuvendin Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike (24-28 nëntor 2021)*, organizuar në Tiranë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

¹ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), *Arkivi i Vjenës (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien)* (më tej: *HHSt.A.PA.A.*).

sllavët me prirje proruse, të cilët përkatësisht do të mbështesnin ose kundërshtonin politikën e Perandorisë Dualiste për të zotëruar pjesën qendrore dhe perëndimore të Gadishullit dhe për administrimin e territoreve të reja në këto anë.

Është me interes të studiohen të dhënat dhe opinioni i diplomatëve austro-hungarezë në periudhën kur Kriza Lindore, që shpërtheu më 1875, ende nuk kishte hyrë në ato zhvillime të nxehta që ndodhën gjatë dhe pas Luftës Ruso-Turke të 24 prillit 1877 - 28 janarit 1878 (Traktati i Paqes midis Perandorisë Ruse dhe Perandorisë Osmane u nënshkrua më 3 mars 1878 në Shën Stefan), kur forcat e armatosura të Serbisë dhe të Malit të Zi depërtuan brenda kufijve të Perandorisë Osmane, në trevat shqiptare, duke terrorizuar popullsinë, çka solli shpërngulje masive dhe ndryshime demografike, veçanërisht në vise të gjera të Sanxhakut të Nishit,² përkatësisht në rajonet e Nishit, Toplicës, Vranjës, Leskovcit, Prokuples, Kurshumlisë (viset e Nishit, Pirotit, Vranjës e Toplicës, 998 fshatra).

Në periudhën mars-qershor 1877, gjatë së cilës u shkrua një raport i detajuar (17 mars 1877)³ mbi organizimin administrativ të vilajetit të Kosovës dhe një memorandum mbi Shqipërinë (20 qershor 1877)⁴ nga konsulli i Austro-Hungarisë, konti Lippih, të cilat na kanë shërbyer si burime të rëndësishme referimi për trajtimin e situatës demografike etnike dhe fetare të popullsisë në sanxhaqet e konsideruara si njësi administrative të Shqipërisë Veriore, ende nuk kishin ndodhur zhvendosje popullsie, kështu që të dhënat janë nga gjendja statike e deriatëhershme.

Gjithsesi, nëse vërtetësia e tyre ishte e diskutueshme, çka e paralajmëron edhe vetë konti Lippih, kjo lidhet me saktësinë e regjistrimeve osmane, me saktësinë e diferencimit nacional të arritur prej tyre, ose edhe me saktësinë e burimeve të tjera të informacionit, që mund të kenë shfrytëzuar diplomatët e Vjenës në Ballkan, për të krijuar bindjen

² *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze*, vëll. I, Instituti i Historisë-Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë: 2008, 2018; Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Tiranë: 1989; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002; Sabit Uka, "Dëbimi me dhunë i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit (1877-1878)", në *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje*, Akademia e Arteve dhe e Shkencave të Kosovës, Prishtinë: 1995, f. 73-74 etj.

³ *HHST.A.PA.A. në AIH, Vj. 29-16.*

⁴ *Po aty, Vj. 29-8.*

kur përpilonin raportet për eprorët, përkatësisht për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll dhe për ministrin e Jashtëm në Vjenë.

Para se të relatonte informacionin për situatën demografike, etnike e fetare që dispononte për vilajetin e Kosovës në kufijtë e krijuar nga Mit'hat Pasha në pranverën e vitit 1877, konsulli Lippih vlerësonte këtë hap të ndërmarrë nga Porta e Lartë sipas këndvështrimit pragmatist të diplomacisë austro-hungareze. Në raport argumentohej se synimi i vezirit të shquar reformator osman ishte krejtësisht politik dhe qëllimi i tij i vërtetë parashikonte përdorimin e shqiptarëve për mbrojtjen e rajonit nga rreziku sllav, duke shmangur, së pari, zgjerimin e Bullgarisë drejt Perëndimit, domethënë krijimin e Bullgarisë së Madhe, që do të mund të shërbente si “pykë” e Rusisë në Ballkan. Duke çmuar rolin e shqiptarëve konsulli vlerësonte pozicionin strategjik të vilajetit të Kosovës dhe kryeqendrës së tij të re, Prishtinës, për të përballuar çdo mësymje nga lindja. Gjithashtu, në raport shënohet përputhja e interesave të Austro-Hungarisë, me veprimin e Mit'hat Pashës për të penguar zgjerimin e shteteve sllave dhe veçanërisht Rusisë në Gadishull, drejt bregdeteve të Adriatikut dhe Egjeut.

Më tej, në memorandumun e 20 qershorit, konsulli trajtonte situatën në sanxhaqet ku banonin “shqiptarët e Veriut”, përkatësisht të Shkodrës, Prizrenit, Prishtinës, Nishit, Shkupit, Dibrës dhe Jeni Pazarit, si edhe në trevën e Mirditës. Ai tërhoqte vëmendjen e Vjenës se:

“Në rrethanat e sotme kombi shqiptar duhet të konsiderohet si një faktor politik që meriton të trajtohet ... dhe të çmohet sipas vlerës së tij të plotë, posaçërisht për shkak të afrimit të rrezikut të sllavizimit të Gadishullit Ballkanik”, sepse ai bën pjesë te “elementet që janë të përshtatshëm për t’i vënë pritë këtij procesi, çka ka një rëndësi të veçantë në çastin e tanishëm. Nga kjo pikëpamje, - vijonte konsulli, - kombi shqiptar ... përbën faktor kryesor ndër elementet jo sllavë të Gadishullit Ballkanik”.

Duke u përqendruar veçanërisht te shqiptarët e Veriut, ose gegët, për të cilët mendonte se vlenin posaçërisht për qëllimet strategjike të Austro-Hungarisë në Ballkan, konsulli Lippih jepte konsideratat e tij për tiparet, për virtytet dhe veset e tyre, duke theksuar veçanërisht disa vlera të spikatura.

“Raca shqiptare, shkruante ai, është energjike, e guximshme dhe e lidhur me dashuri ndaj atdheut dhe institucioneve të vendit ..., inteligjente, me aftësi për t’u edukuar dhe me sensin e një

vështrimi të drejtë në çështjet politike” ..., kurse në gjerat fetare janë të ftohtë, pothuajse indiferentë... Karakteristika të tjera të shqiptarëve, relaton konsulli, janë mikpritja e tyre, mbajtja e shenjtë e fjalës së dhënë, ... qëndrueshmëria, zotësia e tyre morale dhe fizike dhe sedra e zhvilluar në lidhje me konceptet më të gjera mbi nderin”.

Pasi i vlerësonte shqiptarët e Veriut (gegët) me shumë virtyte dhe simpatizantë të Austro-Hungarisë, çka për të ishte edhe kryesorja, konsulli Lippih përvijonte sipas opinionit personal, kufijtë gjeografikë të trojeve të shqiptarëve përgjithësisht dhe të Shqipërisë së Veriut, posaçërisht. Sipas Lippih-it, nisur nga kriteri gjuhësor, kufiri verior i trevave shqiptare kalonte nga Perëndimi në Lindje, prej bregdetit të Adriatikut, “pak nën Tivar”, përmbi shpatet e maleve dhe këndin verior të liqenit të Shkodrës, pastaj përpjetë rrjedhës së lumit të Cemit, nëpër Kuç, Vasojeviç dhe Kolashin (ku shqiptarët i konsideronte të sllavizuar) në Guci dhe Plavë, për të vijuar përpjetë lumit Ibër, në Rozhajë, më tej prej Suhadolit dhe Glugovikut në Duga Poljanë mbi pllajën e Rogoznës deri në perëndim dhe jugperëndim të Jeni Pazarit. Kufiri pas kësaj ngjitej në krahinat e Vuçiternit, Kurshumlisë dhe Prokuples, deri sipër në kufirin me Serbinë, kthehej te lumi i Toplicës deri në derdhjen e tij në Moravën bullgare, duke ndjekur më tej rrjedhën e këtij lumi dhe të Moravicës deri në Kumanovë. Vija që nga kjo pikë, përcaktonte konsulli, drejtohet nga perëndimi përgjatë shpatit jugor të Karadakut (të Shkupit) nëpër Lepenc, çan përmes fushës së luginës së Vardarit, afërsisht te gryka e Treskës në Vardar, kalon përgjatë Treskës, vijon gjatë kufirit të sanxhakut të Manastirit me Dibrën deri në pjesën veriore të liqenit të Ohrit dhe shtyhet në perëndim për në Shkumbin duke zbritur drejt jugperëndimit në Adriatik. Sipas konsullit vendbanime të shqiptarëve veriorë, apo gegëve, gjendeshin edhe përtej kufirit të përmendur, në sanxhaqet e Vidinit dhe të Sofjes, kurse zonën nga Berati deri pak në veri të Durrësit, e vlerëson si trevë kalimtare midis dialekteve gegë e toskë.

Pas informacionit të sipërpërmendur për tiparet e shqiptarëve dhe shtrirjen gjeografike të trevave të banuara nga popullsia shqipfolëse e Veriut, konsulli Lippih ofronte, sikurse shprehej vetë, “një paraqitje aproksimative të raportit të shqiptarëve me kombësitë fqinje”, përmbledhur sipas ndarjes administrative të kohës. Gjysma lindore e “shqiptarëve të veriut”, sipas tij, popullonin rajonet e Prizrenit, Dibrës,

Jenipazarit, Nishit dhe Shkupit, “pra aproksimativisht qarkun e ish vilajetit të Prizrenit”.

“Nuk mund të pretendoj, nënvizonte konsulli, se kam dhënë informacion statistikor për një strukturë të plotë, por sidoqoftë, ai është afër të vërtetës”.

Vështrimi mbi statistikën e ofruara nga Lippih-u, të cilat, do të jepen të plota e të grupuara edhe në tabelë, në fund të kësaj kumtese, japin përmbledhtas këtë tablo për popullsinë shqiptare:

Sanxhaku i Shkodrës për 13 rrethe ose kaza (Shkodër, Podgoricë, Tivar, Ulqin, Zadrimë, Lezhë, Pukë, Krajinë, Anamal, Kuç, Krujë, Durrës, Tiranë), kishte gjithsej 147 000 banorë shqiptarë (87 600 banorë myslimanë, 58 900 banorë katolikë dhe 500 banorë ortodoksë). Popullsia e 13 rretheve, së bashku me 52 750 banorët (7 500 myslimanë dhe 45 250 katolikë) e 17 fiseve malësore të këtij sanxhaku (Mirditë, Hot, Kastrat, Kelmend, Shkrel, Triepsh, Rioll, Grudë, Postribë, Gjovanj, Pulat, Kir, Sumë, Toplanë, Dushman, Shalë, Shosh) jepnin për *sanxhakun e Shkodrës* një popullsi shqiptare prej 199 750 banorësh, e cila zinte rreth 82% (sipas përkatësisë fetare 47,61% myslimanë, 52,14% katolikë dhe 0,25% ortodoksë) të popullsisë së përgjithshme prej 243 550 banorësh. Sipas statistikave 18% e popullsisë joshqiptare përbëhej nga malazezë, serbë ortodoksë (21 800 ose 60,89% e pakicave sllave), boshnjakë myslimanë (11 500 ose 32,12% e pakicave sllave), kroatë katolikë (2 500 ose 6,98% e pakicave sllave), dhe 5 000 vllahë ortodoksë e 3 000 romë* myslimanë. Në popullsinë e sanxhakut të Shkodrës rezulton që shqiptarët përbënin 82% të banorëve, sllavët 14,69% dhe minoritetet e tjera 3,28%.

Popullsinë e sanxhakut të Shkodrës prej rreth 250 000 banorësh të ndarë në afërsisht 160 000 të krishterë dhe 90 000 myslimanë e gjejmë edhe në korrespondencën e kësaj kohe (1897) të përfaqësuesit britanik në legatën e Beogradit drejtuar ministrit, lordit Salisburi (Sellsbëri).⁵

Ndërkohë në *sanxhakun e Prizrenit* për 6 rrethe ose kaza (Prizren, Gjakovë, Pejë, Guci, Tetovë, Lumë) shënohen 278 200 banorë, nga të cilët 199 200 shqiptarë (185 500 ose 93,12% myslimanë dhe 13 700 ose

* Në dokumentin e përkthyer përdoret fjala “jevgj”.

⁵ Bejtullah Destani, *Muhaxhirët, Dosja britanike: Spastrimi etnik i Toplicës, Nishit, Prokuples, Kurshumlisë, Leskocit, Vranjës (1878-1884)*, Prishtinë: Artini, 2019, f. 141-143.

6,87% katolikë). Shqiptarët përbënin 71,6% të popullsisë së përgjithshme të sanxhakut, kurse serbët, malazezët dhe bullgarët ortodoksë, si edhe myslimanët sllavë përbënin rreth 27% të saj, përkatësisht 79 000 banorë. Pakicat vllahe (ortodokse), çerkeze e rome (myslimanë) dhe hebrenjtë ishin në numër të papërfillshëm.

Në *sanxhakun e Prishtinës* për 5 rrethe ose kaza (Prishtinë, Gjiilan, Vuçiternë, Mitrovicë, Vranjë) kishte 194 500 banorë, prej tyre shënohen 90 300 shqiptarë (89 000 ose 98,56% myslimanë, dhe 1300 ose 1.43% katolikë) përkatësisht 47,81% e popullsisë së përgjithshme prej. Serbët (ortodoksë) ndërkohë numëronin 42 500 banorë, bullgarët (ortodoksë) 60 500 banorë, kroatët (ortodoksë) 1200 etj., dhe bënë pjesë përkatësisht me 22,46% dhe 31,1%, 0,6% të popullsisë.

Në *sanxhakun e Nishit* për 3 rrethe ose kaza (Leskovc, Prokuple, Kurshumli) shënohen 136 500 banorë, nga të cilët 58 000 banorë shqiptarë (të gjithë myslimanë), që përbënin 42,49% të popullsisë së përgjithshme. Ndërkohë serbët (ortodoksë) ishin 11 000 banorë dhe bullgarët (ortodoksë) 57 500 banorë, përkatësisht 8% dhe 42,1%.

Duhet saktësuar se në këtë sanxhak pas pushtimit dhe aneksimit nga Serbia në kapërcyell të viteve 1877-1878, u përfshinë edhe 25 000 banorë shqiptarë (100% myslimanë) të Vranjës, çka, sipas konsullit Lippih, e çoi numrin e shqiptarëve para shpërnguljes së tyre masive së paku në 83 000 banorë.

Në *sanxhakun e Shkupit*, shqiptarët në dy rrethe (Shkup dhe Kumanovë) shënohen 31 000 (100% myslimanë), çka do të thotë se ata përbënin 28,31% të popullsisë prej 109 500 vetësh. Bullgarët ishin 59 000 banorë, ose 53,8% e popullsisë, kurse 14 500 ishin myslimanë të përzier, përkatësisht 13,2% e popullsisë. Vështruar në aspektin fetar, myslimanët përbënin 41,5% të popullsisë së rretheve Shkup e Kumanovë.

Më të shumtë paraqiten shqiptarët në *sanxhakun e Dibrës*, ku në 4 rrethe, ose kaza (Dibër e Sipërme, Dibër e Poshtme, Elbasan, Mat) janë shënuar 190 000 (188 000 ose 98,94% myslimanë, 500 ose 0,26% katolikë dhe 1500 ose 0,78% ortodoksë), që do të thotë se shqiptarët përbënin 91,34% të të gjithë popullsisë prej 208 000 banorësh. Pjesa tjetër e saj, përkatësisht 18 000 banorë, domethënë rreth 8% e popullsisë së sanxhakut ishin bullgaro-maqedonë ortodoksë.

Në *sanxhakun e Jenipazarit* në 3 rrethe ose kaza (Jenipazar, Beranë, Rozhajë) shënohen 30 000 shqiptarë (të gjithë myslimanë), shifër që përfaqësonte rreth 22% të popullsisë prej 136 000 banorësh. Në këtë

sanxhak banonin edhe 26 000 myslimanë sllavofolës (19,1%), 8 000 serbë ortodoksë (58,8% e popullsisë). Në këtë sanxhak, në aspektin fetar, myslimanët përbënin 41,15% të popullsisë, kundrejt 58,8% të popullsisë ortodokse.

Për të 7 *sanxhaqet* e sipërpërmendura konsulli Lippih llogariste 798 000 *shqiptarë* (84,76% myslimanë, 14,98% katolikë, 0,25% ortodoksë), të cilët përbënin mbi 60% të popullsisë së përgjithshme.

Veç shqiptarëve konsulli relatton për të 7 sanxhaqet edhe praninë e 500 mijë sllavëve, përkatësisht të 245 000 serbëve (77% ortodoksë, 21,42% myslimanë dhe 1.51% katolikë) dhe 228 500 bullgaromaqedonëve (96,71% ortodoksë, 3,28% myslimanë), të cilët së bashku përbënin 37,73% të popullsisë, si edhe të 45 750 banorëve nga grupe të tjera etnike (romë, çerkezë, vllleh, hebrenj) që përbënin 3,4% të popullsisë.

Kështu në tërësi të 7 *sanxhaqet* ku jetonin “shqiptarët e Veriut” sipas konsullit Lippih, në vitin 1877 kishin një popullsi prej 1 345 000 banorësh, shifër që duhet të jetë më afër realitetit se ndonjë e dhënë që ofrojnë dokumentet britanike në Foreign Office të kohës, të cilat e japin numrin e shqiptarëve në dy milion.⁶ Nëse të dhënat e përgjithshme të popullsisë, të marra nga regjistrimet zyrtare osmane, besohet të jenë pak a shumë të sakta, ndoshta do të duhej arsyetuar e vështuar me rezervë për numrin e popullsisë sllave myslimane, serbe e bullgare, e cila llogaritet në 60 000 banorë. Ndryshe nga çerkezët (14 000) dhe romët myslimanë (19 000), lehtësisht të identifikueshëm gjatë regjistrimeve, është vështirë në të quajturit sllavë myslimanë të diferencosh shqiptarët, që kishin humbur gjuhën shqipe, nga sllavët e mirëfilltë myslimanë. Sidoqoftë, zbërthimi i kësaj të panjohure kërkon studime të mëtejshme që kapërcejnë pretendimet e këtij punimi.

Paraqitja e sistemuar e të dhënave të sipërpërmendura të memorandumit të 20 qershorit 1877, mbi sanxhaqet e Shqipërisë së Veriut, si edhe të raportit të 17 marsit 1877 mbi vilajetin e Kosovës paraqitet në tabelat e mëposhtme:

⁶ *Po aty.*

1. Tabela e përgjithshme e strukturës etnike e fetare e popullsisë në 7 sanxhaqet e Shqipërisë së Veriut e përgatitur sipas të dhënave të memorandumit të 20 qershorit 1877, paraqitet e tillë:

Sanxhaqet					Sllavë							
	Shqiptarë				Serbë				Bullgarë			
	Mys.	Katol.	Ortodok	Gjithsej	Mysl.	Katolik	Ortodok	Gjithsej	Mysl.	Katolik.	Ortod.	Gjithsej
Shkodër	95100	104.150	500	199750	11.500	2500	21800	35800	-	-	-	-
13 rrethe, 17 fise	47,60%	52,14%	0,25%	100%	32,12%	6,98%	60,89%	100%				
				147.000								
				52750								
Prizren	185.500	13.700	-	199200	15000	-	33500	48500	2500	-	26000	28500
6 rrethe	93,12%	6,87%		100%	30,92%		69,07%	100%	8,77%		91,22%	100%
Prishtinë	89.000	1300	-	90300	-	1200	42500	43700	-	-	60500	60500
5 rrethe	98,56%	1,43%		100%	-	2,74%	97,25%	100%	-	-	100%	100%
Nish	58000	-	-	58000	-	-	11000	11000	-	-	57500	57500
3 rrethe	100%			100%			100%	100%			100%	100%
Shkup	31000	-	-	31000	-	-	-	-	5000	-	59000	64000
2 rrethe	100%			100%					7,81%		92,18%	100%
Dibër	188000	500	1500	190000	-	-	-	-	-	-	18000	18000
4 rrethe	98,94%	0,26%	0,78%	100%	-	-	-	-	-	-	100%	100%
Jeni Pazar	30000	-	-	30000	26000	-	80000	106000	-	-	-	-
3 rrethe	100%			100%	24,52%		75,47%	100%				
7 sanxhaqet	676600	119650	2000	798250	52500	3700	188800	245000	7500	-	221000	228500
	84,76%	14,98%	0,25%	100%	21,42%	1,51%	77,06%	100%	3,28%		96,71%	100%

Myslim. të përz.	Sllavë gjithsej	Vllehtë	jev gj	çerkezë	Izraelitë (hebrej)	Të ndryshëm gjithsej	Numri i përgj. i popullsisë	Shqiptarë	Sllavë	Të tjerë
-	35800 100%	5000 Ortod.	3000 Myslim.			8000 100%	243550 100%	199750 82,01%	35800 14,69%	8000 3,28%
2000	79000 100%	2500 vllahë ortodoksë	19000 jevgj myslimanë + 3250 jevgj ortodoksë	14000 myslimanë	2000	37750 vllahë, jevgj, çerkezë, hebrej	278200 100%	199200 71,60%	79000 28,39%	37750 3,43%
-	104200 100%						194500 100%	93000 47,81%	104200 53,57%	
10000	78500 100%						136500 100%	58000 42,49%	78500 57,50%	
14500	78500 100%						109500 100%	31000 28,31%	78500 71,68%	
-	18000 100%						208000 100%	190000 91,34%	18000 8,65%	
-	106000 100%						136000 100%	30000 22,05%	106000 77,94%	
26500	500000 100%	7500 100%	22250 100%	14000 100%	2000 100%	45750 100%	1344000 100%	798250 60,24%	500000 37,73%	45750 3,40%
							Sipas Lipih-ut 1345150			

Mospërputhja midis shifrave të përgjithshme të dhëna nga konsulli Lippih dhe atyre të tabelës, të krijuara sipas shifrave të tij, është 1 250 banorë. Me sa duket, kjo lidhet me ndonjë të dhënë të detajuar, të shkruar gabim. Është për të shënuar gjithashtu, se sanxhaku i Nishit i aneksuar nga Serbia më 1878 kishte në përbërje përveç krahinave të Leskovcit, Prokuples e Kurshumlisë, edhe Vranjën, që në qershor 1877 figuron krahinë e sanxhakit të Prishtinës.

Informacioni shumë i vlefshëm i konsullit austro-hungarez, në të dyja këto dokumente, edhe pse mund të ketë pasaktësi, veçanërisht në këndvështrimin demografik, qoftë për shkak të lëvizjes së kufijve administrative, qoftë për shkaqe të tjera të ndryshme, gjithsesi dëshmon potencialin shumëdimensional të kombit shqiptar, dominimin e padiskutueshëm numerik të tij në trevat në fjalë, të konsideruara vise shqiptare dhe, gjithashtu, llogaritjen e tij si një barrierë të shteteve europiane të Perëndimit për të ndalur sllavizimin e Ballkanit. Ky pozicion i shqiptarëve në shek. XIX, në vitet e Krizës Lindore, merrej në llogari si nga Austro-Hungaria, ashtu edhe nga Rusia dhe aleatja e saj, Serbia, gjithashtu nga ballkanasit e tjerë, por edhe nga Britania e Madhe etj., e padyshim, nga Perandoria Osmane.

Lufta Ruso-Turke e viteve 1877-1878, i dha dorë Serbisë të sulmojë përsëri kufijtë e Perandorisë Osmane, të depërtojë në sanxhakun e Nishit dhe ta spastrojë atë etnikisht nga shqiptarët.

Diskutime e prononcime të shumta, krejt të kundërta, ndonjëherë edhe brenda ambienteve akademike, lidhur me numrin e shqiptarëve të shpërngulur, i japin informacionit të Lippih-ut për situatën demografike të sanxhakut të Nishit para pushtimit serb dhe para shpërnguljes që pasoi, një vlerë të veçantë. Është i njohur fakti se, edhe pse në Kongresin e Berlinit Fuqitë e Mëdha vendosën respektimin e të drejtave të dhjetëra mijëra refugjatëve të pafajshëm shqiptarë, të larguar me dhunë nga vatrat e tyre veçanërisht gjatë dhe pas Luftës së Dytë Serbo-Osmane të zhvilluar më 13 dhjetor 1877 - 25 shkurt 1878, çka u sanksionua edhe në marrëveshjet midis Portës së Lartë dhe Beogradit, asgjë nuk u korrigjua më pas. Për pasojë, një territor prej 10 972 km², i populluar masivisht nga shqiptarët në krahun verior dhe perëndimor të sanxhakut të Nishit, u spastrua etnikisht përmes një politike zyrtare të institucionalizuar në çdo instancë dhe gradualisht u kolonizua dhe u serbizua.

Çfarë ndodhi dihet, pse ndodhi gjithashtu dihet, por të dhënat demografike në prag të shpërnguljes masive na mundësojnë të jemi afër të vërtetës për përmasat e asaj që ndodhi. Autorë të ndryshëm kanë për këtë pikëpamje të ndryshme.⁷ Sipas tyre, vendbanime shqiptare të pastra ose të

⁷ Shih: *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. II; Sabit Uka, *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë*, Prishtinë: 2004 etj.; Masar Rizvanolli, *Lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore (1875-1878)*, Shoqata "Jakova", Gjakovë: 2007; Jovan Hatxhi-Vasiljeviq, *Arbanashka Liga-Arnautska Kongra i Srpski narod u Turskom Carstva (1878-1882)*, Beograd: 1909; Kristo

përziera kanë qenë në sanxhakun e Nishit, sikurse përmendëm më sipër, diku rreth 648 deri 703 vendbanime kurse numri i të shpërngulurve është dhënë nga 30 mijë (sipas Jovan Cvijiçit) në 73 mijë (sipas konsullit rus në Prizren, Jastrebov), mandej në 150 mijë (sipas deklaramit të përfaqësuesve të popullsisë së shpërngulur, shifër që merret e mirëqenë pa koment, edhe nga sferat e larta të diplomacisë britanike) rreth 160 deri 200 mijë (sipas Sabit Ukës) e deri 300 mijë (sipas Shaban Brahës). Në botimin më të fundit kolektiv të historianëve shqiptarë, “Historia e Popullit Shqiptar”, vëll.II, Tiranë 2002, f. 148, pa specifikuar përbërjen kombëtare, jepen 100 000 të ardhur në vilajetin e Kosovës si pasojë e shpërnguljes nga zona e pushtimit serb, gati 38 mijë të ardhur në vilajetin e Manastirit të dëbuar nga ushtritë ruse e bullgare dhe 26 mijë të ardhur në vilajetin e Shkodrës për shkak të ndjekjes nga zona e pushtimit malazez. Vlen të përmendet se në një studim të botuar këtë vit në “Vjetarin” e Arkivit të Kosovës⁸ nga prof. B. Dugolli, flitet për 714 vendbanime të zbrazura nga shqiptarët por në një territor edhe përtej sanxhakut të Nishit e të Pirotit, deri në Graçanisë në afërsi të Prishtinës dhe citohen dokumente osmane që bëjnë fjalë për 320 mijë deri në 350 mijë të shpërngulur nga periferia veriore e Nishit dhe Piroti deri në Kumanovë, Prishtinë e Mitrovicë, shumë nga të cilët pas stabilizimit të kufirit serbo-osman u rikthyen në vatrat e veta. Tërhiqet mandej vëmendja se gjatë periudhës së luftës lëvizjet e popullsisë duhen parë edhe më gjerë, në gjithë vilajetin e Kosovës, madje edhe në atë të Manastirit. Brenda ose jashtë shifrave të përmendura shënohen edhe 18 deri 22 mijë persona të likuiduar ose të vdekur nga të ftohtit e dimrit gjatë shpërnguljes. Në të njëjtin studim theksohet se në qershor të vitit 1878 Komisioni për vendosjen e muhaxhirëve relatonte, për 240 mijë muhaxhirë që kishin nevojë për ushqim e strehë, kurse në fund të vitit për 200 mijë të tillë. Sipas Komisionit, vetëm në Stamboll më 1878 ishin stacionuar 85 mijë muhaxhirë.⁹ Vështrimi i prof. Dugollit, që del

Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Tiranë, 1989; Vladimir Boban, *Jastrebov u Prizrenu*, Prishtina: Jedinstvo, 1983; Emin Pllana, “Shkaqet dhe mënyra e shpërnguljes së muhaxhirëve shqiptarë nga territori i Sanxhakut të Nishit në Kosovë”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e Shkencave Historike, nr.IX, Prishtinë: 1980; *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)*, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë: 1997; Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Tiranë: Lumi-T, 1991; B. Destani, *Muhaxhirët...*, f. 143 etj.

⁸ Bujar Dugolli, “Pasojat e luftës serbo-osmane 1877-1879 dhe reflektimi në marrëdhëniet me shqiptarët”, në *Vjetar*, nr. 39-40, Prishtinë: 2008, f. 195-220.

⁹ Po aty.

nga kuadri i kufizuar vetëm në sanxhakun e Nishit, jep një dimension të ri të argumentuar të eksodit të shqiptarëve në vitet 1877-1878.

Ndërkohë që burime të shumëllojshme ofrojnë një mori informacionesh statistikore, pa saktësuar nëse është fjala vetëm për sanxhakun e Nishit apo edhe përtej tij. Numri i përgjithshëm i shqiptarëve në sanxhakun e Nishit para shpërnguljes, sipas përcaktimeve të ndryshme, është dhënë nga 83 mijë-110 mijë (Feliks Kantz, Carl Sax) deri në mbi 200 mijë (Sabit Uka). Sipas konsullit Lippih, të përmendur më sipër, bëhej fjalë për një popullsi që për 3 rrethet e sanxhakut (Leskovc, Prokuple e Kurshumli), arrinte në 136 000 banorë, prej të cilëve, 58 000 shqiptarë.

Sa është në fakt numri i shqiptarëve që u shpërngulën në dimrin e viteve 1877-1878 nga sanxhaku i Nishit, nëse do të flitet vetëm për të? Hulumtimet e reja në arkiva të dokumenteve të kohës do të na afrojnë pa dyshim tek e vërteta. Por edhe nga të dhënat që dimë dhe me informacionin që na jep konsulli Lippih, mund t'i afrohem kësaj të vërtete.

Sipas të dhënave statistikore të ofruara nga diplomati i njohur në raportin e 17 marsit 1877, popullsia në vilajetin e Kosovës* në vitin 1877 përbëhej gjithsej nga 404 000 shqiptarë (389 000 myslimanë dhe 15 000 katolikë) të shpërndarë përkatësisht në sanxhaqet e Prishtinës (90 300 shqiptarë), Prizrenit (199 200 shqiptarë), Nishit (58 000 shqiptarë) (pa llogaritur Vranjën me 25 000 shqiptarë të përfshirë në sanxhakun e Prizrenit), Shkupit (31 000 shqiptarë) dhe Jeni Pazarit (30 000 shqiptarë).

Në këtë vilajet konsulli shënon edhe 370 000 bullgarë, 225 000 serbë, 71 000 myslimanë të tjerë, 13 000 çerkezë, 3 000 vllahë, 2 000 izraelitë dhe 15 500 të tjerë. Popullsia e përgjithshme llogaritet 1 111 500, nga të cilët 555 000 myslimanë, 556 500 të krishterë dhe 2 000 hebrenj.

Për sa i përket sanxhakut të Nishit pa kazanë e Vranjës (që me këtë ndarje i takonte sanxhakut të Prizrenit) popullsia paraqitej në këtë mënyrë: shqiptarë (myslimanë) 58 000 (+25 000 Vranja), bullgarë (ortodoksë) 57 500 (+60 500 Vranja), serbë (ortodoksë) 21 000, myslimanë të ndryshëm 10 000, çerkezë 4 000, myslimanë (?) 4 000, izraelitë 800. Popullsia e përgjithshme e Sanxhakut (pa Vranjën) ishte 156 800 banorë, përkatësisht 68 000 myslimanë dhe 88 000 të krishterë. Po të shtohet edhe popullsia e Vranjës me

* Vilajeti i Kosovës në ndarjen administrative të sipërpërmendur, pra për Shkodrën dhe Dibërën, u krijua në pranverën e vitit 1877 dhe ekzistoi për rreth 11 muaj.

25 000 shqiptarë dhe 60 500 bullgarë, numri i popullsisë arrinte në 240 800 banorë, nga të cilët 101 000 myslimanë dhe 139 000 të krishterë.¹⁰

Kështu, në sanxhakun e Nishit, sipas konsullit, duke përfshirë kazanë e Vranjës, kishte sipas kazave: në Vranjë 25.000 shqiptarë myslimanë, në Leskovc 24 000 të tillë, në Prokuple 15 000 dhe në Kurshumli 19 000. Ndërkohë shënoheshin për Vranjën 60 500 bullgarë ortodoksë, për Nishin 35 500 bullgarë ortodoksë dhe 10 000 myslimanë të ndryshëm, për Leskovcin 22 500 bullgarë ortodoksë, për Prokuplen 19 500 serbë ortodoksë dhe për Kurshumlinë 1500 serbë ortodoksë. Gjithashtu, sanxhaku numëronte 4 000 romë, 4 000 çerkezë dhe 800 izraelitë.

Sipas këtyre të dhënave sanxhaku i Nishit me gjithë kazanë e Vranjës kishte 240 800 banorë, prej të cilëve, 83 000 shqiptolës të sigurt.¹¹

Nisur nga burime të tjera të cituara, studiuesi S. Uka¹² thekson se duhen shtuar në shifrën e përmendur edhe shqiptarët e Nishit dhe të Pirotit, që nuk janë përfshirë në statistikën e mësipërme, të cilët sipas llogaritjeve të tij të përafërta arrinin rreth 27 000 banorë. Nëse këtë të dhënë e konsiderojmë të mirëqenë, numri i përgjithshëm i shqiptarëve në sanxhakun e Nishit do të arrinte në 110 000 banorë. Pikërisht, ndërmjet shifrave 83 000 dhe 110 000, duhet kërkuar numri i saktë i shqiptarëve të shpërngulur me dhunë në dimrin e viteve 1877-1878 e më pas, nga territori i sanxhakat të Nishit, që aneksoi Serbia, të cilët nuk mundën të rikthehen në pronat dhe shtëpitë e tyre. Edhe pse më e ulët se disa shifra të dhëna nga autorë të ndryshëm, gjithsesi është fjala për një shifër tepër të lartë po të merret parasysh niveli i popullimit të trevave ballkanike në këtë kohë. Një e treta e popullsisë së sanxhakat të Nishit u larguan pa kthim nga vendbanimet e veta. Shifrat më të larta, që jepen nga autorë të ndryshëm, me sa duket, kanë të bëjnë me shpërngulje nga territore më të gjera se sanxhaku i Nishit, nga shpërngulje edhe të myslimanëve joshqiptarë, pra, të myslimanëve përgjithësisht, por ndoshta edhe të atyre familjeve bullgare, që nuk e gjetën të përshtatshme të jetonin nën regjimin e ri serb. Nuk përjashtohet mundësia që të llogariten edhe të larguarit nga vise të tjera që qenë teatër luftimesh gjatë Luftës Ruso-Turke dhe të aksioneve të bandave çetnike në prapavijat e fronteve të luftimeve. Gjithsesi saktësimi i shifrës për shpërnguljen e madhe të viteve 1877-1878, mbetet një çështje e hapur.

¹⁰ *HHST.A.PA.A.* në *AIH*, Vj. 29-16; B. Destani, *Muhaxhirët ...*, f.143.

¹¹ *Po aty*, Vj. 29-8.

¹² S. Uka, *Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit ...*, f. 26.